



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2018:033616

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05497430

P.nr.240/16

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me sekretaren juridike Indira Beqa, në lëndën penale, në procedurën e veqar ndaj të pandehurit L.N nga fsh...-Kaçanik, për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-se, sipas Aktakuzes të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1235-2/14 të datës 14.01.2016, jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë 25.03.2024 mori këtë

A K T V E N D I M

HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1235-1/14 e datës 14.01.2016, ndaj të pandehurit L.(E...) N... nga fsh...-Kaçanik, I lindur me dt..., me nr.personal:..., për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPK-se, për shkak se është shkaktuar ndalesa absolute për ndjekje penale.

I dëmtuarit A. B. nga fsh....Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës bijnë në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngrit aktakuzën PP.nr.1235-2/14 të datës 14.01.2016, kundër të pandehurit L.N nga fsh...-Kaçanik, për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPK-së.

Gjykata konstatoi se vepra penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPK-së, është kryer mes datës 01-07 Tetor 2013.

Sipas nenit 106 par.1 të KPK-së, 04/L-082, për veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPK-së, është paraparë afati i parashkrimit prej 5 vite, ndërkaq sipas nenit 107 par.8 të KPK-së, është paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit.

Prandaj në bazë të kësaj, gjykata konstaton se për veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPK-së, me datë 07.10.2023 ka arritur afati i parashkrimit.

Meqë nga dita e kryerjes së veprës penale dhe ditës së marrjes së këtij aktvendimi kanë kaluar më tepër se dhjetë vite, gjykata ka gjetur se ekzistojnë shkaqet për hudhjen e aktakuzës sepse është shkaktuar parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në contest civil u mor konfor nenit 462 par.2 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.240/16 datë 25.03.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.